



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Prishtinë, 22 mars 2024  
Kodi i ZRRE-së: V\_1875\_2024

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, Nenit 15 dhe Nenit 26 paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Nenit 8, paragrafët 1 dhe 6, të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e Rregullës dhe Metodologjinë për Përgatitjen e Balanceve të Energjisë Nr.03/2020 (e nxjerrë në qershor 2020); dhe
- Kërkesën e bërë me datë 07 nëntor 2023 nga **Ndërmarrja Publike "Termokos" sh.a.**, me adresë 28 Nëntori, Ulpianë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, për miratimin e dokumentit "Bilanci Vjetor i Energjisë Termike për vitin 2024".

**në seancën e mbajtur më 22 mars 2024 nxori këtë:**

## **V E N D I M**

- I. APROVOHET "Bilanci vjetor i energjisë termike për vitin 2024" i Ndërmarrjes Publike "Termokos" sh.a.**
- II. Obligohet i licencuari që pas pranimit të këtij Vendimi ta publikojë dokumentin "Bilanci Vjetor i Energjisë Termike - 2024" në faqen elektronike zyrtare të tij.**

## **A R S Y E T I M**

- Ndërmarrja Publike "Termokos" sh.a. (në vijim Termokos) si bartëse e Licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike, bazuar në dispozitat ligjore të legjislacionit në fuqi ka përgatitur dokumentin "Bilanci Vjetor i Energjisë Termike për vitin 2024". Në përputhje me procedurat ligjore dhe rregullative, drafti parë i këtij dokumenti është dorëzuar me 7 nëntor 2023 për shqyrtim në ZRRE dhe në Ministrinë e Ekonomisë. Pas shqyrtimit dhe komentimit të këtij drafti nga këto dy institucione, me 6 dhjetor 2023 është dorëzuar drafti final i përmirësuar sipas komenteve, i cili është konsideruar i finalizuar për tu paraqitur para Bordit të ZRRE-së për miratim.
- Pas shqyrtimit të draft-dokumentit "Bilanci Vjetor i Energjisë Termike për vitin 2024" të dorëzuar nga NP Termokos dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ME dhe ZRRE-së, Bordi i ZRRE, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



3. Duke pasur parasysh ndikimin e parametrave të ndryshëm të bilancit në përcaktimin e tarifave, Rregullatori mban të drejtën që gjatë shqyrtimit tariforë të përshtatë të dhënat që përmban Bilanci vjetor i energjisë termike.
4. Bazuar në dispozitat e Nenit 42, paragrafit 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Rregullatori monitoron implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë Termike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në këtë Bilanc dhe mund të ndërmarr veprime specifike për promovimin dhe përmirësimin e sigurisë afatshkurtër dhe afatgjatë të furnizimit me energji.
- V. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodhë e fundit.


Bashkëngjitur:


“Bilanci Vjetor i Energjisë Termike – 2024”


Vendimi ju dërgohet:


- Ndërmarrjes Publike “Termokos” sh.a. dhe
- Arkivit të ZRRE-së


Bordi i ZRRE-së:

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Lutfije Dervishi, Anëtare

  
Gani Buçaj, Anëtar

  
Arta Qorolli, Anëtare

  
Adnan Preniqi, Anëtar